

20131874631

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12 dhe 23/13), neni 82 ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin dhe aplikimin e ligjeve dhe dispozitave tjera në kulturë e kryejnë inspektorët për kulturë (inspektor).

(2) Inspektor mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është në moshë madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është kumtuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose obligimeve,
- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1 në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë, që dëshmohet me certifikatë ose diplomë,
- ka pesë vite përvojë pune në fushën e kulturës,
- i plotëson kushtet tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës,
- posedon certifikatë të njohur në nivel ndërkombëtar për punë me programe kompjuterike për punë në zyre, dhe atë një prej këtyre në vijim:

1) Certipor: IC3 GS4 Key Applications – i dhënë;

2) Microsoft: MOS Word или MOS Excell – i dhënë ose

3) ECDL: Core – i dhënë,

- ka marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës nëpërmjet dhënies së testit psikologjik dhe testit për integritet, në pajtim me dispozitat të cilat kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe

- ka licencë për inspektor nga fusha e kompetencës së shërbimit inspektues.

(3) Inspektori punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryen në shërbimin inspektues të Ministrisë së Kulturës."

Neni 2

Pas nenit 82 shtohet nen i ri 82-a, si vijon:

"Neni 82-a

(1) Ministri i Kulturës përpilon propozim-program vjetor për punë të shërbimit inspektues dhe të njëjtin e parashtron te Këshilli inspektues, më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Ministri i Kulturës, e miraton programin vjetor për punë të shërbimit inspektues në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimi të pëlqimit nga Këshilli inspektues, përkatësisht më së shumti deri më 10 dhjetor në vitin rrjedhës nëse Këshilli Inspektues nuk e shqyrton dhe nuk parashtron pëlqim, përkatësisht vërejtje në afatin e caktuar me Ligj.

(3) Në bazë të programit vjetor të miratuar, ministri i Kulturës përpilon plane tremujore për punë të secilit inspektor, të cilat të përmbledhura i dërgon në shqyrtim në Këshillin Inspektues më së shumti dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik, deri më 15 mars për të dytin, deri më 15 qershor për të tretin, përkatësisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punë për secilin inspektor, ministri i Kulturës në mënyrë obliguese e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e kompleksitetit të secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore, për secilin inspektor, ministri i Kulturës përpilon plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve sipas datave dhe subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Ministri i Kulturës, më së shumti dy javë nga fillimi i tremujorit rrjedhës kalendarik për atë paraprak, në Këshillin inspektues në mënyrë përmbledhëse parashtron raporte tremujore për punën e secilit inspektor, dhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, përkatësisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Ministri i Kulturës, më së voni deri më 1 mars në vitin rrjedhës, në Këshillin inspektues parashtron raport vjetor për punën e shërbimit inspektues për vitin paraprak."

Neni 3

Në nenin 84 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Për ankesë ndaj aktvendimit të inspektorit vendos Komision Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.”

Paragrafi (4) shlyhet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, kurse do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.